

# TLAS



# SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 1 2011



AVOKATI I POPULLIT



BASHKIMI EUROPIAN



SHËRBIMI LIGJOR FALAS  
“TLAS”

**Avokati i Popullit dhe Shërbimi Ligjor Falas “TLAS”**

**ORGANIZOJNE SEMINARIN KOMBETAR**

**“Shoqëria Shqiptare Sfidat e Mosdiskriminimit”**  
20 Dhjetor 2010

Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) dhe asgjë në këtë botim, në asnjë rrethanë, nuk do të vlerësohet si pasqyrim i pozicionit të Bashkimit Europian.

## MISIONI I TLAS

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) është regjistruar si organizatë jo fitimprurëse, e pavarur, me Vendimin Gjykatë Nr. 346, datë 18/12/2006, themeluar nga CAFOD UK.

TLAS ka filluar aktivitetin si program i Cafod Albania, që në vitin 1999 dhe vazhdon të ofrojë shërbim ligjor falas për kategoritë në nevojë për çështje civile.

Plotësimi i nevojave ligjore të njerëzve në nevojë, sensibilizimi i tyre mbi të drejtat themelore të njeriut, nxitja e ndryshimeve të sistemit ligjor, në funksion të përmirësimit të kushteve ekonomiko-sociale të individëve dhe grupeve vulnerabël.

## OBJEKTIVAT E TLAS

- Të ofrojë shërbime të plota ligjore për shtresat në nevojë të shoqërisë;
- Të sigurojë që njerëzit në nevojë të kenë më shumë akses në sistemin ligjor;
- Të ndërmarrë inisiativa për përmirësime në legjislacion, advokim dhe lobbing për realizimin e tyre;
- Të ndikojë në përmirësimin e qeverisjes, përmes përfshirjes së grupeve vulnerabël;
- Të botojë të dhëna mbi probleme të rëndësishme ligjore dhe të të drejtave të njeriut, që janë ndeshur gjatë trajtimit të rasteve të klientëve të TLAS.

## BORDI DREJTUES

Av. Dashamir Kore  
Av. Maksim Haxhia  
Suzana Sakiqi  
Shkëlqim Bozgo  
Viktor Gumi

## GRUPI KËSHILLIMOR

Av. Ardjana Fullani  
Dr. Tefta Zaka  
Av. Dashamir Kore  
Av. Natasha Sheshi  
Av. Perikli Zaharia

## STAFI I TLAS

Dr. Rajmonda Bozo  
Av. Vangjel Kosta  
Av. Elton Lula  
Dr. Elvira Dervishi  
Av. Naureda Llagami  
Migen Elmazaj  
Av. Anisa Haxhijaj  
Av. Adrian Shega

## “RRITJA E AKSESIT NË DREJTËSI TË GRUPEVE VULNERABËL”

TLAS është duke zbatuar një projekt thellësisht human, të mbështetur nga Bashkimi Europian, me titull “ Rritja e aksesit në drejtësi të grupeve vulnerabël” , projekt që nxjerr në dukje rast pas rasti sesi shteti i së drejtës dhe strukturat e tij, administratat përkatëse të këtyre pushteteve shfaqin mangësi të mëdha në shërbimet që ato ju ofrojnë qytetarëve dhe taksapaguesve. Dhe shpjegimi i vetëm për këtë është padrejtësia, e cila thënë ndryshe përkthehet në diskriminimin që u bëhet në mënyrë të veçantë individëve të varfër, atyre që kanë qëlluar të jenë “më të pabarabartë se të barabartët”.

Në kuadër të këtij projekti më datë 20 Dhjetor 2010, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS dhe Avokati i Popullit organizuan **Seminarin Kombëtar me temë**

“Shoqëria Shqiptare – Sfidat e Mosdiskriminimit” në ambjentet e Hotel Tirana Internacional. Synimi i Seminarit ishte sensibilizimi i organeve vendimarrëse dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë shqiptare për zbatimin efektiv të çdo lloj legjislacioni që ndihmon anti - diskriminimin e individëve vulnerabël dhe shpresave të varfra në përgjithësi.

Duke vlerësuar të drejtën për mosdiskriminim si një të drejtë themelore kushtetuese të individit, prania e Avokatit të Popul-



lit, për vetë natyrën e funksionimit të tij, ishte një ndihmesë tepër e konsiderueshme në procesin e hapave lobuese që ndërmerren në këtë fushë nje organizatë jo fitimprurëse si TLAS.

Në këtë tryezë të hapur në sallën Consortium, të Hotel Tirana Internacional morën pjesë 68 pjesëmarrës, si nga institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Brendshme, Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, donatorë, organizata partnere, studentë

të fakulteteve juridike dhe përfitues të TLAS, etj.

Dihet teorikisht që e drejta e mosdiskriminimit përbën thelbin dhe moralin e çdo ligji që derivon nga kartat ndërkombëtare, nga kushtetutat kombëtare dhe nga çdo burim tjetër i së drejtës dhe që dallon jo vetëm një shtet demokratik nga ai jodemokratik, por mbi të gjitha edhe një shoqëri demokratike, tolerante, falëse, përfshirëse, nga një shoqëri përjashtuese, ndëshkuese, intolerante.

Konkluzionet e këtij seminari ju kushtuan sigurisht mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë. Diskutimet dhe sugjerimet e diskutantëve në këtë aktivitet u përvijuan në një sërë rekomandimesh, të cilat në thelb mbështesin fuqishëm grupet e përcaktuara si grupe vulnerabël ndaj çdo lloj diskriminimi të mundshëm. Më poshtë po rendisim disa prej tyre:

- Është fakt se në Shqipëri tashmë ekziston një sistem i tërë





legjislativ, për ndërtimin e të cilit janë ngritur edhe strukturat përkatëse administrative. Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10221 datë 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", vlerësojmë se tashmë është hedhur një hap cilësor në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, i konkretizuar edhe me krijimin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me kompetenca jo thjesht rekomanduese por edhe vendim-marrëse. Megjithatë, nisur nga gjendja aktuale e funksionimit të këtij institucioni të ri, shumë të rëndësishëm në kuadër të mbrojtjes nga diskriminimi, ne nxisim Qeverinë të alokojë sa më parë fondet e duhura që ky institucion të fillojë aktivitetin e tij normal, me qëllim që mbi të gjitha kjo zyrë të fillojë të njihet nga vetë publiku, dhe më pas të fitojë dhe justifikojë besimin e tij.

- I duhet dhënë një frymëmarrje më e gjerë dhe evidente, rolit të shoqërisë civile, i konkretizuar në ndihmën konkrete ndaj individëve subjekte të diskriminimit,

apo me oponencën direkte ndaj veprimtarisë së organeve të administratës shtetërore e më gjerë që mbron individin nga diskriminimi.

- Ndihma konkrete e drejtëpërdrejtë ligjore ndaj individëve, e ofruar nga organizma të shoqërisë civile që veprojnë në vend, nxjerr si nevojë shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve dhe bashkëpunimin real dhe të vazhdueshëm ndërmjet shoqërisë civile dhe organeve të specializuara të administratës shtetërore.





- Në të gjithë veprimtarinë e të gjithë aktorëve dhe faktorëve në luftën ndaj diskriminimit, prioritet duhet të mbetet promovimi dhe njohja nga ana e individëve e të drejtave të tyre themelore, veçanërisht i së drejtës për mbrojtjen nga diskriminimi në të dy format e tij.

### ***Për fëmijet dhe shtresat në nevojë:***

- Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, duhet të përbëjë një prioritet për të gjithë aktorët dhe faktorët në vend që veprojnë për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Duke

vënë si kriter parësor interesin më të lartë të fëmijës, e drejta për mbrojtjen nga diskriminimi të fëmijëve përbën edhe kryefjalën e veprimtarisë së të gjithë organeve të administratës publike e më gjerë. Promovim dhe koordinim i veprimtarisë të të gjitha mekanizmave qeveritare për çështjet me fëmijët në të gjitha nivelet.

- Duke parë me shqetësim pjesëmarrjen e gjerë të fëmijëve në fushatat elektorale të partive të ndryshme politike, me synimin e sensibilizimit të të gjitha forcave politike shqiptare për të mos përfshirë fëmijët në mitingjet elektorale, nuk duhet harruar që fëmijët nuk kanë pjekurinë intelektuale, fizike apo mendore njësoj si të rriturit, dhe shpesh ata nuk e kuptojnë qëllimin e këtyre organizimeve apo mitingjeve. Është pikërisht kjo mungesë e pjekurisë intelektuale të tyre arsyeja që fëmijët kanë nevojë për një mbrojtje të veçantë.

- Nisur nga monitorimi i shtypit dhe mediave televizive për respektimin e të drejtave të fëmijëve

jëve, veçanërisht në lidhje me të drejtën për mosdikriminim, disa nga rekomandimet janë;

- Gazetarët duhet të rrisin pasqyrimin e problemeve të fëmijëve në media dhe t'a zgjerojnë atë edhe me analiza të gjendjes së të drejtave të fëmijëve;

- Gazetarët duhet t'i trajtojnë fëmijët si gjithë njerëzit e tjerë dhe jo në mënyrë paternaliste, sensacionale, viktimizuese apo shfrytëzuese;

- Duke pasur parasysh gjithë kujdesin që duhet treguar kur trajton fëmijët, gazetarët duhet të përpiqen të rrisin praninë dhe vizibilitetin e fëmijëve në media;
- Gazetarët duhet të tregojnë vëmendje të veçantë për gjuhën dhe termat që duhen të përdoren, sidomos kur pasqyrohen krime dhe drejtësia për të mitur;

- Gazetarët gjithnjë duhet të kenë parasysh përkufizimin e interesit më të lartë që është ai i fëmijës, kur marrin vendime për të intervistuar fëmijët dhe për të botuar informacion rreth tyre.

- Gazetarët duhet të respektojnë të dhënat personale dhe



të ruajnë identitetin e fëmijëve, sidomos në kronikat e zeza.

- Nevojitet përsosja e legjislacionit për fëmijët. Për fat të keq në Shqipëri nuk ekziston ende një përmbledhje unike që të përfshijë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me fëmijët dhe të drejtat e tyre. Dispozitat që ekzistojnë në lidhje me fëmijët janë të shpërndara në shumë ligje të ndryshme dhe akte nënligjore.

- Nevojitet nxitje e inkurajim i të drejtës së shprehjes së opinionëve të fëmijëve dhe inkurajim i Qeverisë dhe publikut që t'i kushtojë atyre vëmendjen e duhur.

- Është i nevojshëm një përqendrim mbi fëmijët më të cënuar, që jetojnë në kushte të vështira, të diskriminuar dhe të nxjerrë në plan të dytë nga mungesa e burimeve dhe kushteve për një jetë me cilësi të mirë.

- Edukimi duhet të shërbejë si një nga kushtet e nevojshme për njohjen e të drejtës për mosdiskriminim dhe shmangien e diskriminimit ndaj fëmijëve dhe individëve në tërësi.

- Denoncimi me forcë i çdo rasti diskriminimi, duhet të vlerësohet si mjet i rëndësishëm për paran-

dalimin e këtij fenomeni.

- Gjatë aktivitetit u theksua mungesa e një kuadri ligjor, i cili të parashikojë një mbështetje të veçantë të moshës së tretë, si shtresë në nevojë. Moshimi përbën një problem jo vetëm për vendet e zhvilluara, por edhe për vendet në zhvillim dhe prek të gjithë aspektet e jetës social - ekonomike e politike të individit. Për këtë arsye kujdesi për të moshuarit, për plotësimin e nevojave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, duhet të jetë një nga prioritetet në kuadër të kujdesit social. Eviden-tohet se në zbatim të Planit të Veprimt të Dokumentit të Politikave Ndërsektoriale për Moshën e Tretë, miratuar në vendimin nr. 763 datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave është hartuar projektligji "Për kujdesin e Moshës së Tretë". Në këtë kontekst theksojmë se është i domosdoshëm miratimi sa më i shpejtë i këtij ligji, me qëllim që kjo shtresë të mos ta ndiejë veten të diskriminuar.





### **Për personat me aftësi të kufizuar:**

- Aktualisht është miratuar me VKM nr.8 datë 7.01.2005 "Strategjia Kombëtare për personat me aftësi të kufizuar", me objektiva dhe me plan konkret veprimi. Gjithashtu, është ecur në mënyrë progresive drejt përmirësimeve ligjore apo hartimit të ligjeve të reja, ku trajtimi i problematikave të personave me aftësi të kufizuara po zë vend gjithnjë e më shumë. Të tilla përmirësime janë bërë në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"; Ligjin nr. 7952 datë 21.06.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", Dispozitat normative, i ndryshuar; Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodën Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë"; Ligji nr. 10119 datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit"; Ligji nr.7995 datë 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit", i ndryshuar; Ligji nr.9232 datë 13.05.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", i ndryshuar;

Ligji nr.10221 datë 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Megjithatë, kuadri ligjor ekzistues në fuqi, nuk garanton nivelin e duhur të mbrojtjes ligjore ndaj diskriminimit për disa kategori personash me aftësi të kufizuara, duke i bërë ata vulnerabël ndaj diskriminimit. Të tillë persona, janë personat me aftësi të kufizuara mendore dhe shqisore.

Më konkretisht:

- Nuk përfitojnë shërbim kujdestarie personat me aftësi të kufizuara mendore, një gjë e





tillë parashikohet vetëm për ata persona që kanë aftësi të kufizuara të thella në kuptim të ligjit, apo për personat e tillë deri në moshën 7 vjeç, duke përjashtuar kështu të gjithë pjesën tjetër të këtyre individëve.

- Nuk përfitojnë shërbime rezidenciale apo ditore. Edhe kur këto shërbime jepen janë të kufizuara dhe ofrohen mbas moshës 25 vjeç.

- Nuk përfitojnë shërbimin e përkthimit të gjuhës së shenjave, personat me aftësi të kufizuara në dëgjim, gjë që për rrjedhojë sjell edhe humbjen e së drejtës së

tyre për t'u arsimuar.

- Nuk përfitojnë shërbime personat me aftësi të kufizuara pas moshës së punës, pra ata persona që në keto kushte kanë dalë në pension.

- Nuk janë të parashikuara në legjislacionin përkatës alternativa votimi jashtë qendrave të votimit, për personat me aftësi të kufizuara që nuk paraqiten dot në këto qendra, gjë që sjell për pasojë humbjen e së drejtës së tyre për të votuar.

- Nuk ka procedura transparente dhe gjyqësisht të kontrollueshme për përcaktimin e nivelit të aftësisë së kufizuara dhe as trajtime të diferencuara për personat me kufizime më të rënda në aftësinë e kufizuara.

Për të gjitha këto raste nevojitet përmirësimi i kuadrin ligjor ekzistues në fuqi, apo edhe plotësimi i legjislacionit me akte të reja ligjore, të cilat llogjikshëm do të parandalojnë gjendjen e diskriminimit real ndaj këtyre kategorive personash, duke shërbyer njëkohësisht edhe si garanci për ushtrimin real të të drejtave të

tjera themelore kushtutese të këtyre personave me aftësi të kufizuara.

- Mosnxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nga ana e organeve përkatëse të administratës publike, sikurse në rastet e Ligjit nr.7995 datë 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit", apo Ligjit nr.9232 datë 13.05.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", i ndryshuar, bën që personat me aftësi të kufizuara të ndjehen të diskriminuar në këto fusha. Për rrjedhojë, del si kërkesë imperative nxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve të mësipërme me qëllim ndalimin e gjendjes diskriminuese të krijuar ndaj personave me aftësi të kufizuar për këtë shkak.

- Shkak kryesor për diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuar është moszbatimi i legjislationit në fuqi, i cili sanksionon të drejta për këtë kategori individësh.

- Duhet ndërmarrë hapa konkrete për përmbushjen dhe

sigurimin e kriterit të akomodimit të arsyeshëm, si një kërkesë kryesore e parashikuar në Konventën "Për te drejtat e personave me aftësi të kufizuara" dhe si një parakusht për integrimin e vendit në BE.

- Nga të gjitha institucionet e specializuara shtetërore apo edhe nga organizmat përkatës të shoqërisë civile, duhet të jepet shembulli dhe modeli konkret i respektimit të së drejtës së individit për mbrojtjen nga diskriminimi.



**Për pakicat kombëtare (romet):**

- Përmirësimi i të dhënave statistikore në fushën e edukimit (arsimi parashkollor – arsimi i lartë), me qëllim analizimin e gjendjes arsimore të fëmijëve romë. Hartimi i një legjislacioni me karakter më liberal në fushën e arsimit për romët.
- Eliminimi i qëndrimeve përjashtuese dhe inferiore ndaj Romëve në komunitetin shkollor dhe transformimi i diversitetit kulturor në një burim njohurish dhe atmosfere të respektit reciprok, tolerancës dhe mirëkuptimit ndaj tyre.

- Rritja e përfitimeve për minoritetin Rom nga skemat e mbrojtjes sociale me anë të ndërmarrjes së masave lehtësuese.
- Ofrimi i mundësive për akses në strehim dhe në infrastrukturë në përputhje me standardet shtetërore në zonat me popullsi Rome.
- Kryerja e rregullt dhe periodike si një proces në vazhdim i regjistrimit të popullsisë rome, në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

**Angazhim të strukturave shtetërore për regjistrimin e fëmijëve të braktisur (dorëzuar të afërmeve të prindërve nga vetë prindërit por pa dokumentacion ligjor).**

- Identifikimi i rasteve të abuzimit të fëmijëve rom që punojnë në rrugë dhe reduktimi i tyre me anë të masave ndëshkuese.
- Rritja e numrit të individëve rom, në skemën e detyruar të sigurimeve shoqërore, me qëllim që të përfitojnë nga kjo skemë, nëpërmjet krijimit të lehtësirave procedurale specifike për shkak





të nivelit të ulët arsimor, kulturor dhe ekonomik...

- Rritja e aksesit të komunitetit Rom në sistemin shëndetësor publik. Përmirësimi i kushteve higjeno-sanitare në vendbanimet e popullsisë Rome.

- Krijimi i kushteve për ruajtjen dhe kultivimin e trashëgimisë Kulturore të Minoritetit Rom. Krijimi i një ambjenti social përfshirës dhe vlerësues ndaj diversitetit kulturor të Romëve.

- Arsimimi i komunitetit rom dhe punësimi i tyre, duhet parë nga Qeveria, jo vetëm si një detyrim kushtetues, por si një nga mënyrat më efektive për integrimin e tyre të plotë në shoqëri. Pa ndërhyrje energjike në këto dy fusha prioritare për daljen e komunitetit rom nga gjendja ku ndodhet, nuk mund të flitet për pjesëmarrjen e barabartë, në kuptimin e plotë të fjalës, në një shoqëri të hapur dhe në përputhje me qëndrimet e Gjykatës të Drejtave të Njeriut, që kërkojnë parandalimin dhe dënimin e çdo lloj diskriminimi direkt ose indirekt që mund të bëhet ndaj çdo individi.



Në perfundim u theksua se:

Moszbatimi i ligjit "Për Ndhmën Juridike" në shkallë vendi, edhe pse ai është miratuar që në Dhjetor 2008, është një fakt tjetër që flet se mbrojtja nga diskriminimi i individëve vulnerable është e drejtë e cunguar dhe e munguar. Gjithashtu mos përjashtimi i individëve vulnerabel nga taksat gjyqësore dhe tarifa të tjera është pengesë e konsiderueshme për aksesin e tyre në drejtësi. Këto dhe probleme të tjera që janë të lidhura

me zbatimin e ligjeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, etj mbeten çështje të rëndësishme për t'u trajtuar në të ardhmen si nga strukturat përkatëse të shtetit ashtu edhe nga aktorët e rëndësishëm të shoqërisë civile.

**Raimonda BOZO**  
Drejtoresh Ekzekutive e TLAS



## Histori e Vërtetë 1

Në Shërbimin Ligjor Falas Tiranë (TLAS) u paraqit S.S. për të kërkuar ndihmë për ndjekjen e procedurave gjyqësore të zgjidhjes së martesës së saj me M. S. Ajo kishte vite që nuk bashkëjetonte me bashkëshortin dhe bile ata jetonin në qytete të ndryshme. S.S. jeton në një barakë në Bregun e Lumit, sëbashku me dy fëmijët që kishte patur me M. S. Nga informacionet që ajo kishte, M. S. bashkëjetonte me një grua tjetër dhe kishte edhe fëmijë të tjerë me këtë grua. S. S. dëshironte që mbasi të bënte zgjidhjen e martesës, të transferonte dokumentat e gjendjes civile në Tiranë, ku ajo edhe banon dhe të përpiqej të përfitonte nga programet sociale të ofruara nga Bashkia e Tiranës, sidomos për strehimin.

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë filloi nga puna për grumbullimin e dokumentave të nevojshme për të bërë zgjidhjen e martesës, nëpërmjet procedurave gjyqë-

sore. Për këtë arsye, u siguruan çertifikata familjare dhe çertifikatat personale të dy fëmijëve. Njëkohësisht TLAS mbuloi të gjitha shpenzimet për të pajisur S. S. me letërnjoftimin e ri elektronik, meqë në bazë të rregullave në fuqi, nuk mund të hapej procedura në gjykatë, pa këtë dokument. I vetmi dokument që nuk mundëm të siguronim, ishte çertifikata e martesës. Zyra e gjendjes civile ku S. S. ishte e regjistruar, nuk kishte asnjë të dhënë në regjistër (numri dhe data e Aktit të Marteses), që



do të mundësonte plotësimin e çertifikatës së martesës. Dukej sikur punonjësi i gjendjes civile të asaj komune, nuk ishte treguar i rregullt dhe nuk kishte hedhur në Regjistrin Themeltar të shtetasve të dhënat e martesës së S. S. Për këtë arsye, u drejtuam në Arkivin e Gjendjes Civile të rrethit, ku mbahen librat e Akteve të martesave, për të marrë një çertifikatë martese. Meqënëse nuk kishim asnjë të dhënë për datën e mbajtjes së martesës, sepse as S. S. nuk e mbante mend se

kur kishte ndodhur, punonjësjë u detyrua të kërkonte në librat e akteve të shumë viteve. Por nuk u gjet akti i kërkuar i martesës. Mbas shumë verifikimeve edhe në regjistrat themeltarë, ku mendohej se mund të ishte transferuar çifti përgjatë viteve, nuk u gjet asnjë gjurmë e martesës.

Sipas S. S. ajo nuk kishte firmosur ndonjë akt martese dhe mendonte se vjehrra e saj kishte "bërë martesën". Punonjësi i gjendjes civile të asaj kohe, kishte vdekur dhe nuk mund të mernim ndonjë informacion prej tij. Mbas konsultimeve edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, arritëm në përfundimin që martesa duhej të konsiderohej e pavlefshme. Kjo pavlefshmëri duhej të shpallej nga gjykata. Aktualisht TLAS po ndjek procedurat gjyqësore të shpalljes së pavlefshmërisë së martesës. Mbase të arrihet kjo gjë, S. S. do marrë statusin "beqare", ndërkohë që dy fëmijët, do vazhdojnë të mbajnë atësinë, meqë regjistrimi i fëmi-





jëve ishte bërë në prani të të dy prindërve. Më tej, TLAS do vazhdojë me procedurat administrative të transferimit të S. S. dhe plotesimit të dokumentave për të përfshirë familjen e saj, në programet e strehimit të Bashkisë së Tiranës.

**Elvira Dervishi**  
Këshilltare e Programit, TLAS



## Histori e Vërtetë 2

Në një histori të vërtetë, të përshkruar në një nga numrat e revistës të vitit 2010, ishte përshkruar edhe rasti i R. E. Ajo kishte bërë martesë me një shtetas të huaj dhe atje kishte lindur edhe një vajzë. Më vonë, në çift u krijuan probleme dhe R., sëbashku me vajzën u kthyen në Shqipëri. Bashkëshorti i saj bëri zgjidhjen e martesës në gjykatë dhe gjykata i dërgoi R.E. një kopje të vendimit të zgjidhjes së martesës.



R. E. nuk kishte marrë asnjë dokument për regjistrimin në shtetin e huaj të të gjitha ngjarjeve të gjendjes civile, si lidhja e martesës dhe lindja e vajzës së saj. Në atë histori të vitit 2010, tregonim se si mundëm të sigurojmë çertifikatën origjinale personale të vajzës dhe çertifikatën origjinale të martesës. Më vonë TLAS vazhdoi me procedurat për legalizimin e këtyre dy çertifikatave, që ato të bëheshin të zbatueshme në Shqipëri. Për këtë, çertifikatat u dërguan për t'u vërtetuar nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Jashtme e shtetit X dhe më tej, u legalizuan në konsullatën shqiptare atje.

Çertifikatat origjinale, të legalizuara, të lindjes së vajzës dhe ajo e martesës, pasi u përkthyen dhe noterizuan, u dorëzuan në zyrën e gjendjes civile, ku R. E. ishte e regjistruar. Në bazë të këtyre çertifikatave, u shtua në regjistër vajza e saj dhe statusi i gjendjes civile të R., nga "beqare", u bë "e martuar".

Hapi tjetër që duhej bërë, ishte

sigurimi i vendimit origjinal të zgjidhjes së martesës, lëshuar nga gjykata e huaj dhe legalizimi i vendimit, në organet përkatëse të atij shteti dhe në konsullatën shqiptare në atë shtet. Mbas një korrespondence me shkrim me gjykatën e huaj, mundëm të siguronim vendimin origjinal të zgjidhjes së martesës. Më tej, vazhduam me procedurat për legalizimin e këtij vendimi.

Në mënyrë që vendimi për zgjidhjen e martesës të bëhet i zbatueshëm në Shqipëri, duhet që ky vendim të dërgohet në Gjykatën shqiptare të Apelit dhe atje të bëhet njohja e tij. TLAS ka përgatitur dhe ka dorëzuar në Gjykatën e Apelit të Tiranës kërkesën për njohjen e këtij vendimi. Jemi në pritje të përfundimit të procedurave në këtë gjykatë. Mbas të merret vendimi i Gjykatës shqiptare të Apelit, ky vendim do të dërgohet në zyrën e gjendjes civile dhe mbasi të zbatohet, gjendja civile e R. E. do të ndryshohet, nga “e martuar” në “e shku-

rorëzuar”. Me këtë hap, përfundojnë të gjitha procedurat për rregullimin e regjistrimeve të familjes së R. E.

Mund të themi, që me punën e vazhdueshme që u bë për këtë rast, TLAS ndihmoi një nënë kryefamiljare, që nuk kishte asnjë mundësi financiare dhe as njohuritë e nevojshme, për t'i ndjekur vetë gjithë këto procedura ligjore në një shtet të huaj dhe në Shqipëri.

**Elvira Dervishi**  
**Këshilltare e Programit, TLAS**



## PASOJAT E ZGJIDHJES SË MARTESES PËR ISH-BASHKËSHORTËT

Pjesë mjaft e rëndësishme që pason procesin e zgjidhjes së martesës janë edhe pasojat për ish-bashkëshortët që lidhen kryesisht me përdorimin e mbiemrit pas martesës, kontributi kompensues si dhe e drejta e përdorimit të banesës. Me rastin e zgjidhjes së martesës, ish-bashkëshortët iu nënshtrohen edhe pasojave që sjell kjo

zgjidhje për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur si pasojë e jetës së tyre të përbashkët.

Le ti marrim me radhë:

### a) Përdorimi i mbiemrit

Bashkëshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës.

Gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës.

Pra, është e rëndësishme të theksohet fakti se me zgjidhjen e martesës bashkëshorti që e ka ndryshuar mbiemrin merr automatikisht mbiemrin që ka pasur përpara se të martohet, ndërsa nëse ai kërkon të mbajë mbiemrin e marrë nga martesa duhet t'i drejtohet gjykatës me kërkesë dhe të vërtetojë para saj se nga ndryshimi i mbiemrit atij do ti vijë një dëm shumë i madh në jetesën e tij.





### b) Kontributi Kompensues

Para së gjithash duhet të sqarohet se çfarë kuptojmë me kontribut kompensues.

Me kontribut kompensues kuptojmë faktin kur gjykata detyron njërin nga ish-bashkëshortët të derdhë për llogari të tjetrit një kontribut të destinuar për të kompensuar sa të jetë e mundur pabarazinë që mund të shkaktojë në jetën e tjetrit ndarja e pasurisë në zgjidhjen e martesës, përveç detyrimit për ushqim.

Gjykata përcakton nëse kontributi mund të jepet i menjëhershëm ose periodik dhe mënyrën e pagimit të tij.

Kontributi kompensues caktohet sipas nevojave të ish-bashkëshortit përfitues dhe burimeve të tjetrit, duke marrë në konsideratë gjendjen në çastin e zgjidhjes së martesës dhe kohëzgjatjen e saj në një të ardhme të parashikueshme.

Kohëzgjatja e dhënies së kontributit kompensues caktohet nga gjykata, sipas nevojave të ish-bashkëshortit përfitues.

Nëse ish-bashkëshorti përfitues



lidh martesë të re, kontributi kompensues ndërpritet.

Sipas nenit 149 të Kodit të Familjes ka disa kriterë në përcaktimin e kontributit kompensues siç janë:

- a) moshë dhe gjendja shëndetësore e ish-bashkëshortëve;
- b) koha e shpenzuar dhe atë që i duhet të shpenzojnë për edukimin e fëmijëve;
- c) kualifikimin e tyre profesional;
- ç) predispozitën e tyre për punë të reja;
- d) të drejtat që ata gëzojnë dhe ato që parashikohen për të ardhmen;
- dh) pasurinë e tyre.

Gjithashtu gjykata mund të vendosë edhe për ndryshimin e kontributit kompensues në rast se vazhdimi i tij sjell pasoja tepër të rënda për ish-bashkeshortin që është i detyruar ta paguajë atë.

c) *E drejta e përdorimit të banesës*

Në rast se banesa familjare është në pronësi të njërit ish-bashkëshort dhe bashkëshorti tjetër nuk ka në pronësi banesë tjetër të përshtatshme në vendbanimin e tyre, gjykata mund të lejojë përdorimin nga ish-bash-

këshorti jopronar të banesës kur:

a) fëmijët i janë lënë për rritje dhe edukim këtij të fundit, derisa ata të arrijnë moshën madhore;

b) zgjidhja e martesës bëhet nga ish-bashkëshorti pronar për ndërprerje prej tij të jetesës së përbashkët. Në këtë rast e drejta e përdorimit të banesës është deri në 7 vjet, por në rast se ish-bashkëshorti jopronar rimartohet, e humbet këtë të drejtë;

c) kur ish-bashkëshorti jopronar ka instaluar në banesën e ish-bashkëshortit pronar një kabinet



profesional me vlerë të madhe, lëvizja e të cilit do të kërkonte shpenzime të mëdha. Në këtë rast e drejta e përdorimit është deri në 3 vjet.

Në këto raste gjykata përcakton afatin e përdorimit dhe masën e qirasë që detyrohet të paguajë ish-bashkëshorti jopronar në përputhje me të ardhurat e tij.

Këto ishin tre pjesë të rëndësishme që vijnë si pasojë e zgjidhjes së martesës dhe ndryshimeve që sjell martesë në jetesën e bashkëshortëve.

**ADRIAN SHEGA**  
Avokat, TLAS

## Histori e Vërtetë 1

### Ndryshimi i detyrimit për ushqim

**P**ranë zyrës tonë u paraqit një kliente me initiale F.K, pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë ajo u paraqit duke kërkuar pension ushqimor për djalin e saj të mitur të lindur nga martesë, pasi ajo kishte zhvilluar procedurat e divorcit dhe e kishte fëmijën e mitur B.K për





ritje dhe edukim ndërsa bashkëshorti tjetër kishte detyrimin për të kontribuar për mirëritjen e fëmijës së mitur.

Janë pikërisht këto raste të cilat po shtohen dita ditës në shoqërinë shqipëtare, pasi siç dihet është rritur mjaft numri i martesave që përfundojnë me divorce dhe janë pikërisht këto probleme që hasen pas ndërprerjes së bashkëjetesës pra shuma e pamjaftueshme e detyrimit për ushqim për shkak të ndryshimit të kushteve të jetesës dhe moshës së të miturve që e përfitojnë atë. Pasi fëmija jeton me njërin nga prindërit dhe fakti

se fëmija nuk jeton me prindin tjetër nuk e shkarkon atë nga detyrimi për të kontribuar për një jetesë më të mirë të fëmijës së tij.

U procedua me mbledhjen e dokumentave të nevojshëm të cilat vërtetonin faktin që fëmija jetonte me nënën si dhe dokumentat që vërtetonin se ky detyrim i caktuar nga gjykata nuk i përmbushte nevojat e fëmijës pasi kishin ndryshuar kushtet dhe pagesa ishte mjaft e vogël. Gjithashtu u mbledhën dokumentat që u konsideruan të nevojshëm për fillimin e procesit gjyqësor.

U mendua që të hartohej një kërkesë duke kërkuar shtimin e detyrimit për ushqim.

Sipas nenit 192 pika "b" e Kodit të Familjes "Detyrim për ushqim kanë prindërit ndaj fëmijës së tyre", pavarësisht nëse fëmija ka lindur jashtë martesë apo nga martesa, madje neni 196 përmend faktin se edhe në qoftë se njërit nga prindërit i është hequr përgjegjësia prindërore, përsëri ai nuk mund ti shmanget detyrimit për ushqim ndaj fëmijës së tij.



Neni 197 prashikon “Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar. Një fëmijë i mitur mund t’u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij. Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhore ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç”.

Neni 207 i Kodit të Familjes prashikon: “Gjykata, me kërkesën e personit të interesuar, mund të pakësojë, të heqë ose të shtojë detyrimin për ushqim, të caktuar me vendim të formës së prerë, kur rrethanat në bazë të të cilave është dhënë vendimi kanë ndryshuar më vonë. Detyrimi për ushqim mund të pakësohet edhe për shkak të sjelljes së çrregullt ose të qortueshme të personit që e përfiton atë. Nëse pas përcaktimit të detyrimit për ushqim konstatohet se një nga personat e detyruar në shkallë të mëparshme është në gjendje



që ta japë atë, gjykata vendos zëvendësimin këtij detyrimi. Në këtë rast, person i detyruar në shkallën e mëpasme nuk çlirohet nga ky detyrim, pa u caktuar detyrimi për ushqim ndaj personit në shkallën e mëparshme.” Pra duke iu rikthyer rasis të klientes F.K, duke marrë parasysh moshën e mitur të djalit të saj dhe vështirësinë financiare në të cilën ajo ndodhej, ajo në bazë të të gjithë neneve të përmendur më lart përligjej plotësisht në kërkimin e saj, duke kërkuar një jetë më të mirë për fëmijën e saj. U depozitua kërkesë padia në gjykatë dhe u procedua me

hapat e mëtejshëm, ku u zhvilluan disa seance gjyqësore dhe gjykata arriti në përfundimin se klientja F.K kishte të drejtë në kërkimin e saj duke i lidhur në këtë mënyrë një detyrim ushqimor në një masë më të madhe i cili i përgjigjej më shumë situatës në të cilën ndodhej klientja F.K. Në këtë mënyrë ky fëmijë do të ketë një të ardhme më të mirë dhe do të ketë mundësi më të mëdha për të pasur një jetesë normale njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë.

**ADRIAN SHEGA**  
**Avokat, TLAS**



## Histori e Vërtetë 2

### Njohja e vendimeve të shteteve të huaja

**P**ranë zyrës tonë u paraqit një kliente me initiale R.E, pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë ajo u paraqit duke kërkuar njohjen e vendimit civil në shtetin Shqiptar të një gjykate të një shteti të huaj. Vihet re një shtim i numrit të vendimeve të shteteve të huaja në fushën civile sidomos përsa i përket vendimeve që prekin çështje që kanë lidhje me familjen. U proçedua me mbledhjen e dokumentave të nevojshëm sic ishte kryesor vendimi i gjykatës. U mendua që fillimisht të ndiqeshin hapat për verifikimin e të gjithë dokumentacionit që nevojitej sipas kriterëve ligjore. Sipas nenit 396 të Kodit të Procedurës Civile " Kërkesës për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet te plotesojë këto kushte:

Kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri. Vërtetim nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimi e legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit ashtu edhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë".



U procedua duke legalizuar pranë konsullatës përkatëse vendimin e gjykatës i cili përmbante të gjitha vultat përkatëse të gjykatës që e kishte lëshuar dhe me pas u procedua me përkthimin e tij në gjuhën shqipe dhe me noterizimin pranë një noteri publik.

Në këto kushte u përpilua kërkesa për njohjen e këtij vendimi në shtetin shqiptar.

Sipas nenit 395 të Kodit të Procedurës Civile "Kërkesa për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj i paraqitet gjykatës së apelit."

Gjykata e apelit nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394.

Kështu në këto kushte vlen të theksohet se neni 394 është mjaft i rëndësishëm për rastin që po trajtojmë pasi ky nen parashikon pengesat ligjore pse nuk mund të zbatohet në shtetin shqiptar një vendim i një shteti të huaj.

Sipas nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile: "Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shq-



ipërisë kur:

- a. sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës të shtetit që ka dhënë vendimin;
  - b. kërkesëpadia dhe letërthirja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet;
  - c. midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;
- ç. është duke u shqyrtuar nga

gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë; d. i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij; dh. nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Vendimi i paraqitur nga klintja R.E nuk përmbante asnjë nga këto pengesa ligjore që ta bënë atë të pazbatueshem në shtetin Shqiptar.

U depozitua kërkesa në gjykatë dhe u procedua me hapat e mëtejshëm, gjykata e apelit arriti në përfundimin se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj që i përkiste klientes R.E duhej njohur në Shqipëri.

Në këtë mënyrë kjo familje ia arriti qëllimit të saj që pasojat që sillte vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të njiheshin edhe në Shqipëri.

**ADRIAN SHEGA**  
**Avokat, TLAS**



## **PENSIONET E PLEQËRISË, PROCEDURA PËR APLIKIMET, ANKIMET ADMINISTRATIVE DHE GJYKIMET**

**P**ensioni i pleqërisë është ajo e drejtë e çdo individi për të përfituar nga skema e sigurimeve shoqërore një masë të caktuar përfitimi në kushtet kur nuk është më i aftë për punë sipas përcaktimëve që bën ligji. Akti ligjor më anë të të cilit rregullohet e gjithë skema e pensioneve, duke nisur që nga mënyra e mbledhjes së kontributeve nga personat aktivë, që kryejnë një punë dhe derdhin kontribute, e deri në përcaktimin e kriterëve për përfitimin e pensionit është ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Në Kreun III të këtij ligji parashikohen llojet e pensioneve që paguhen nga dega e sigurimeve shoqërore. Ndër të tjera është edhe pensioni i pleqërisë, si një nga llojet e pensioneve që paguhen nga

dega e sigurimeve shoqërore. Sipas Nenit 31 e në vijim të ligjit “Për Sigurimet Shoqërore” dhe ndryshimeve që i janë bërë këtij ligji në vazhdim parashikohet që vetë pensioni i pleqërisë ndahet në dy lloje: pension i plotë pleqërie dhe pension i pjesshëm pleqërie.

1. Pensioni i plotë i pleqërisë mund të përfitohet nga të gjithë individët në Republikën e Shqipërisë të cilët plotësojnë këto kushte:

a) Kanë mbushur moshën për dalje në pension e cila është 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç për gratë;



- b) Kanë plotësuar 35 vjet sigurim;
- c) Janë tërhequr nga veprimtaria ekonomike.

Sipas po këtij neni të ligjit parashikohet një rregullim i veçantë dhe i favorshëm për një kategori të cilat janë nënat me shumë fëmijë. Si të tilla konsiderohen ato gra të cilat kanë lindur 6 ose më shumë fëmijë që janë më shumë se 8 vjeç. Kjo kategori ka të drejtë të përfitojë pension pleqërie të plotë në momentin që mbushin 50 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim.



2. Pensioni i pjesshëm i pleqërisë mund të përfitohet nga të gjithë individët në Republikën e Shqipërisë të cilët plotësojnë këto kushte:

- a) Kanë mbushur moshën për dalje në pension e cila është 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç për gratë;
- b) Kanë plotësuar më pak se 35 vjet dhe më shumë se 20 vjet sigurim;
- c) Janë tërhequr nga veprimtaria ekonomike.

Pensioni i pjesshëm caktohet si pjesë e pensionit të plotë. Ky pension llogaritet duke shumëzuar pensionin e plotë me vitet e sigurimit dhe duke bërë pjesëtimin me 35.

Në momentin dhe në rastin që çdo individ plotëson kriteret që ka përcaktuar ligji, ai ka të drejtë ti drejtohet Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore të vendbanimit të tij, duke i paraqitur dokumentat e nevojshme që vërtetojnë moshën (dokument identifikimi) dhe dokumentat që vërtetojnë vjetërsinë në punë (li-

brezën e punës ose vërtetimet e punës nga qendrat e punës ku ka punuar).

Drejtoria Rajonale kryen verifikimet për të vërtetuar për vitet e punës dhe masën e kontributeve që janë derdhur. Drejtoria Rajonale në rastin kur gjen të rregullt dhe të vërtetuar vjetërsinë në punë merr vendim për caktimin e pensionit. Në rast të kundërt kur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore konstaton parregullsi gjatë verifikimeve të kryera merr vendim për moscaktimin e pensionit (vendim negativ).

Aplikuesi për pension ka të drejtë të ankohet ndaj vendimit të përfitimit në Komisionin Rajonal të Ankimit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Ky Komision shqyrton ankimin dhe vendos në lidhje me të brenda një muaji nga data kur është paraqitur ankimi. Nëse Komisioni Rajonal nuk vendos në favor të aplikuesit për pension, atëherë ky i fundit ka të drejtë që t'i drejtohet Komisionit



Qendror të Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Afatet që duhen respektuar nga aplikuesi për pension për t'iu drejtuar Komisionit të Ankimit si më sipër janë 1 muaj nga dita që aplikuesi ka marrë dijeni për vendimin për të cilin ai kërkon të ankohet.

Kur aplikuesi për pension ka eza­ruar procesin e ankimit admini­strativ dhe vendimet janë dhënë negative duke mos i caktuar pensionin, ai ka të drejtë ti drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku bën pjesë Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore ku ka bërë aplikimin, brenda 30

ditëve nga dita kur ka marrë dënimin për Vendimin e Komisionit Qëndror të Ankimit.

Padia me anë të së cilës, në këto raste i drejtohet Gjykatës është një padi administrative me anë të së cilës kundërshton një akt administrativ (vendimet e komisioneve të sigurimeve shoqërore) dhe si e tillë, gjykimi në këto raste zhvillohet kryesisht në bazë të provave shkresore që vërtetojnë vjetërsinë në punë. Dokumenti kryesor në këtë rast është librezja e punës e cila përmban një provë të plotë sipas ligjit për të vërtetuar vjetërsinë e pun-

nës. Gjykata shqyrton çështjen në themel duke dëgjuar pretendimet e paditësit (pensionistit) dhe të paditurit (DRSSH dhe ISSH).

Në përfundim gjykata, mbi bazën e pretendimeve, provave të paraqitura dhe mbi të gjitha nëse provohet në gjykim me anë të dokumentave dhe provave shkresore fakti që pensionisti ka punuar, vendos në lidhje me kërkimet e padisë duke shfuqizuar vendimet e komisioneve dhe duke i dhënë të drejtë aplikuesit për pension që t'i lidhet pensioni dhe ti paguhet





që nga momenti që i ka lindur e drejta për pension.

Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk është vendim i formës së prerë nëse ndaj këtij vendimi ushtrohet ankim nga palët ndërgjyqëse brenda afatit 15 ditor nga shpallja e vendimit. Nëse një nga palët ushtron ankim atëherë çështja gjykohet në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit shqyrton ligjshmërinë dhe vendos lidhur me pretendimet e palëve në lidhje me çështjen në gjykim. Vendimi i Gjykatës së Apelit është vendim i formës së prerë dhe si i tillë përbën titull ekzekutiv dhe është i detyrueshëm për tu ekzekutuar nga palët.

**Adnan Hoxha**  
Avokat, TLAS

## Histori e Vërtetë 1

### Përgjegjësia prindërore dhe caktimi i kujdestarit

Përgjegjësia prindërore është një nga konceptet me të rëndësishme të parashikuara nga Kodi i Familjes, pasi lidhet drejtpërdrejtë me mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës. Në Kodin e Familjes ekzistojnë po ashtu edhe rastet në të cilat lejohet që një prindi ose prindërve t'iu hiqet përgjegjësia prindërore, specifikisht kur





prindërit e shpërdorjnë këtë përgjegjësi ose janë në pamundësi për ta ushtruar.

Një rast i tillë u paraqit edhe në zyrën tonë, klientja F.A ishte gjyshja e fëmijëve për të cilët kërkohej të hiqej përgjegjësia prindërore dhe të caktohej kujdestari. Prindërit e fëmijëve kishin jetuar në Greqi për një periudhë të gjatë kohore bashkë me fëmijët dhe aktualisht vuanin dënimin me burgim prej 12 vjetësh secili. Në këto kushte fëmijët ishin kthyer në Shqipëri dhe jetonin me gjyshërit. Ishin gjyshërit që "de facto" ushtronin kujdestarinë duke u kujdesur për

mirëritjen e tyre. Megjithatë atyre iu lindte nevoja që këtë kujdestari ta kishin ligjore në mënyrë që të mund të përfitonin nga ndihmat sociale që parashikon legjislacioni në fuqi në lidhje me këtë rast.

Pasi u paraqit në zyrën tonë dhe pasi u diskutua çështja nga këshilltari i projektit dhe nga të gjithë avokatët e zyrës u mendua që të mblidheshin dokumentat e nevojshëm dhe të paraqitej çështja në gjykatë.

Sipas nenit 215 të Kodit të Familjes: Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij. Pra në rastin tonë kishim të bënim me një rast tipik për heqje të përgjegjësisë prindërore për njërin nga prindërit e fëmijës i cili nuk mbante raporte të afërta me fëmijën e tij.

Sipas nenit 224 të kodit të Familjes "Ne qofte se prinderit e femijes kane vdekur, jane ne pamundësi të ushtrojnë përgjegjësi prindërore për shkak të pazotësisë për të vepruar të mungesës së tyre ose për arsye të tjera të rënda, fëmija mund ti besohet një anëtarit të familjes". Për shkaqet e sipër përmendura prindërit e fëmijëve ishin në pamundësi të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore për shkak të mungesës së tyre.

Sipas nenit 228 të Kodit të Familjes: Kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve, me kërkesën e prindit tjetër, të të afërmeve të fëmijës ose të prokurorit, mund t'i hiqet përgjegjësia prindërore.

Heqja e përgjegjësisë prindërore bëhet me vendim të gjykatës, duke u thirrur si i paditur prindi, për të cilin kërkohet kjo heqje.

Gjithashtu përgjegjësia prindërore mund të kthehet me vendim të gjykatës, kur pushon

shkaku për të cilin është hequr kjo përgjegjësi, pra kur prindi i fëmijës e kupton se veprimet e tij nuk kanë qenë të mira dhe kane ndikur jo pozitivisht në edukimin e fëmijës.

Po ashtu sipas nenit 263 të Kodit të Familjes "fëmijët e mitur vendosen në kujdestari kur prindërit e tyre kanë vdekur, u është hequr përgjegjësia prindërore, si dhe për çdo shkak të pranuar nga gjykata".

Sipas nenit 264 të Kodit të Familjes "të drejtën e paraqitjes së kërkesës në gjykatë për kujd-



estar mbi të miturin e kanë: të afërmit e fëmijës së mitur ...".

U procedua për mbledhjen e të gjithë dokumentave të nevojshëm që do të shërbenin në këtë rast duke marrë të gjithë dokumentat e kërkuara nga gjykata.

Pasi u mbledhën këto dokumenta u përpilua kërkesa për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe u paraqit kërkesa në gjykatë.

Pas disa seancave gjyqësore gjykata arriti në përfundimin se e gjente të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesën e bërë nga klienti F.A. duke i dhënë të drejtë për kërkimin e tij.

U arrit në përfundimin e kërkuar nga klientja F.A dhe u vlerësua puna e bërë nga Zyra për Shërbimin Ligjor Falas për zgjidhjen e kësaj çështje.

**Adnan Hoxha**  
**Avokat, TLAS**

## Histori e Vërtetë 2

### Zgjidhja e marrëdhënieve të punës në mënyrë të pajustifikuar

Marrëdhënia juridike e punës është marrëdhënia që krijohet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit në të cilën parashikohet që punëmarrësi merr përsipër të kryej punën në





shpërblim të pagës që i jepet nga punëdhënësi. Marrëdhënia e punës vërtetohet nëpërmjet kontratës së punës dhe në mungesë të saj nëpërmjet librezës së punës. Një fenomen i cili ka qënë prezent dhe i dukshëm është zgjidhja e pajustificuar e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësit. Legjislacioni që rregullon marrëdhëniet e punës (Kodi i Punës) parashikon shprehimisht rastet dhe procedurat që duhen respektuar në rastin kur punëdhënësi vendos të zgjidhë në mënyrë të njëan-



shme marrëdhënien e punës. Neni 153 i Kodit të Punës parashikon se punëdhënësi e punëmarrësi në çdo kohë mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të arsyeshme. Konsiderohen si shkaqe të arsyeshme të gjitha rrethanat, që objektivisht nuk lejojnë ti kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës. Gjykata vendos vetë nëse kanë ekzistuar shkaqe të arsyeshme për zgjidhjen e kontratës. Konsiderohen si shkaqe të arsyeshme në ngarkim të punëmarrësit vetëm ato raste kur ai vepron me faj të rëndë, sidomos thyen në mënyrë të përsëritur disiplinën në punë, megjithë paralajmërimet e punëdhënësit. Një rast i tillë u paraqit edhe në zyrën tonë, klientja T.H e shihet të padrejtë largimin e saj nga detyra, duke pasur parasysh edhe faktin që ajo kishte punuar për një periudhë rreth 40 vjet pranë të paditurit dhe i duheshin edhe rreth dy vjet për të mbushur moshën e daljes në pension dhe gjatë gjithë kësaj periudhe kishte punuar me kor-

rektësi dhe asnjëherë nuk ishte kritikuar apo të kishte marrë vërejtje në lidhje me punën e kryer. Po ashtu kësaj klienteje fillimisht i ishte komunikuar në mënyrë verbale ky fakt dhe vetëm pasi ajo kishte bërë një ankese i ishin shpjeguar shkaqet të cilat ishin jo ligjore dhe jo të arsyeshme.

Pasi u paraqit në zyrën tonë dhe pasi u diskutua çështja nga këshilltari i projektit dhe nga avokatët e zyrës u mendua se largimi nga detyra i klientes ishte

bërë në mënyrë të padrejtë duke mos respektuar asnjë nga afatet ligjore dhe rregullat e parashikuara nga Kodi i Punës. Sipas Kodit të Punës "Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedoj me të. Punëdhënësi, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të marrë për zgjidhjen e kontratës. Zgjidhja njoftohet të paktën pas 48 orëve të bisedës. Ajo duhet të bëhet me shkrim.

Punëdhënësi i klientes T.H nuk kishte respektuar asnjë nga afatet e mësipërme dhe kishte shkelur dispozitat e parashikuara nga neni 143 dhe 144 të Kodit të Punës. Sipas nenit 143 të Kodit të Punës "Për punëmarrësin gjatë vitit të parë të punës afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës është 1 muaj, për 2 deri në 5 vjet punë afati është 2 muaj, për më shumë se 5 vjet punë afati është 3 muaj.

Punëdhënësi, që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme,



detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëshmipërblim deri në një vit page që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit.

Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje me shkrim ose në kontratën kolektive të punës. Po ashtu Neni 152 i Kodit të Punës parashikon që "Në përfundim të marrëdhënieve të punës që kanë zgjatur jo më pak se tre vjet, punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsinë si në rastin e zgjidhjes së kontratës me afat të pacaktuar nga punëdhënësi". Nëse kontrata zgjidhet pa shkaqe të arsyeshme, punëmarrësi ka të drejtë të ngrejë padi kundër punëdhënësit në gjykatë, brenda 180 ditëve nga dita e përfundimit të afatit të njoftimit.

U procedua për mbledhjen e të gjithë dokumentave të nevojshëm që do të shërbenin në këtë rast duke u marrë të gjithë dokumentat.

Pasi u mblodhën këto dokumenta u përpilua kërkesa për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe u paraqit kërkesa në

gjykatë.

Pas disa seancave gjyqësore gjykata arriti në përfundimin se e gjente të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesën e bërë nga klientja T.H duke i dhënë të drejtë për kërkimin e tij. Në këto kushte u arritën me sukses kërkesat e klientes T.H dhe u vlerësua puna e bërë nga Zyra për Shërbimin Ligjor Falas për zgjidhjen e kësaj çështje.

**Adnan Hoxha**  
**Avokat, TLAS**



## MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI DHE GARANCITË QË OFRON LIGJI

**N**ë kushtetutën e Republikës së Shqipërisë përcaktohet (neni 18):

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike,

arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Parami i mosdiskriminimit ose i të qënurit i barabartë me të tjerët është një e drejtë themelore dhe kjo garanci ofrohet jo vetëm nga ligji themeltar i vëndit, Kushtetuta, por si e drejtë themelore e cila gjen përkufizimin e saj në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe së fundi edhe në ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga Diskriminimi" si në çdo legjislacion tjetër të vendeve demokratike.

Njerëzit me njëri-tjetrin janë të ndryshëm për arsye nga më të ndryshmet. Pikërisht fakti i të qenit të ndryshëm me njëri-tjetrin për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzanisë, për-





katësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose të çdo shkaku tjetër, na jep të drejtën për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë me çdo person tjetër, pasi të qenit të ndryshëm nuk duhet të na bëjë të ndjehemi dhe të trajtohemi jo të barabartë me të tjerët.

Çdo person ka të drejtë t'i garantohet e drejta për t'u mbrojtur nga situata pabarazie ku mund të gjendet kushdo në jetën e tij. Garancia nënkupton një mbrojtje ligjore dhe mjete procedurale efektive për tu mbrojtur nga çdo shkelje e parimit të barazisë së personave me njëri tjetrin dhe ndërmjet tyre dhe shtetit, pra një mbrojtje dhe garanci në linjë horizontale dhe vertikale.

Deri para disa kohësh ky parim gjente rregullim në sistemin e brendshëm vetëm në kushtetutën e Republikës së Shq-



ipërisë, ai sigurohej edhe nga marrëveshjet ndërkombetare për ratifikimin e konventave mjaft të rëndësishme të cilat kanë në thelb të drejtat dhe liritë themelore.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi i shkurtit të vitit 2010 është i vonshëm në kohë por ardhja e tij në fuqi ka sjellë një përfshirje, mbrojtje, garanci ligjore dhe procedurale për të drejtën për të qenë të barabartë dhe për mos t'u diskriminuar. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;





b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;

c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjeljeje që nxit diskriminimin.

Por duhet theksuar se ky ligj nuk siguron një përcaktim teorik dhe nuk ka një përmbajtje thjesht deklarative sikurse mund të duket nga përkufizimet që ai jep në nenin 3 të tij :

1. "Diskriminimi" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo

preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

2. "Diskriminim i drejtpërdrejtë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

3. "Diskriminim i tërthortë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të

këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

4. "Diskriminim për shkak të shoqërimit" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë.

5. "Shqetësim" është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një

trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

6. "Udhëzim për të diskriminuar" është një udhëzim ose kërkesë, bazuar në marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

7. "Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme" është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë



kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepër, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji..."

Ky ligj gjithashtu përcakton dhe njëkohësisht krijon edhe organe të reja në mbrojtje dhe në zbatim të të drejtës së gjithësecilit për tu ankuar ndaj sjelljeve dis-

kriminuese që janë bërë ndaj tyre.

Ankimi realizohet nëpërmjet kërkesëpadisë në gjykatë, duke bërë që e drejta për t'u mbrojtur nga një trajtim jo i barabartë apo diskriminues t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor. Ligji gjithashtu parashikon krijimin e një komisioni shtetëror ankimi i cili shqyrton, jep vendim dhe cakton edhe gjoba për ankesa të bëra nga personat të cilët mendojnë se janë diskriminuar.

Komisioneri, që përfaqëson personin që qëndron në krye të këtij institucioni ka këto kompetenca sipas ligjit :

a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka



ndodhur diskriminimi;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;

ç) të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji;

d) të nxisë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara;

dh) të monitorojë zbatimin e këtij ligji;

e) të kryejë sondazhe në lidhje me diskriminimin;

ë) t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit

ekzistues;

f) të publikojë raporte dhe të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;

g) t'i drejtohet drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;

gj) me kërkesën e gjykatës që shqyrton çështjen, të parashtrijë mendim me shkrim për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;

h) të kontribuojë në raportimet





dhe sipas rastit të paraqesë raporte para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë;

i) të përfaqësojë ankuesin në organet gjyqësore në çështje civile me miratimin e tij në përputhje me pikën 3 të nenit 34 të këtij ligji;

j) të informojë për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;

k) të zhvillojë dialogun e rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat

joqeveritare;

l) të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

2. Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke dhënë informacionin që i nevojitet atij.

3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.

4. Detyrimi i përmendur në pikën 2 të këtij neni përmbushet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Por si mund t'i drejtohem kësaj strukture kur ne mendojme se është shkelur e drejta jonë për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë më të tjerët?




Komisionerit mund t'i drejtohem nëpërmjet një kërkesë të bërë me shkrim ose në raste përjashtimore edhe me gojë para komisionerit në mënyrë që të mund të mbahet procverbal. Bazuar në kërkesat e ligjit, marrja në shqyrtim nga ana e komisionerit e kërkesës, kërkohet në mënyrë që ajo të ketë një formë sa më të plotë, ajo duhet të përmbajë të paktën: emrin e ankuesit; shpjegimin se si mund të kontaktohet ankuesi; subjektin që pretendohet të ketë kryer diskriminimin ose shpjegimin për pamundësinë e identifikimit të tij; shpjegimin e diskriminimit të pretenduar; masat që kërkohen të merren nga komisioneri; datën dhe firmën e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij.

Ligji gjithashtu parashikon që personi të mund t'i drejtohet edhe organeve të tjera administrative për t'u ankuar ndaj një sjelljeje diskriminuese. Ato janë : Punëdhënësi; Drejtuesi i institucionit arsimor; personi fizik apo juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun. Ankimi që paraqitet pranë këtyre institu-

cioneve nuk ka ndonjë normë detyruese nga ligji që ta për-caktojë.

Me mjaft rëndësi për t'u theksuar është fakti që ky ligj e zgjeron mundësisë e ankimit të personave dhe veç kësaj e lejon personin apo grupin e personave të cilët kanë bërë kërkesën të shterojnë atë rrugë që atyre i duket më e përshtatshme dhe ankimi pranë komisionerit mund të bëhet pavarësisht ankimit që mund të jetë bërë pranë punëdhënësit apo ankimit të bërë në gjykatë apo anasjelltas.

Me mjaft rëndësi mbetet ankimi gjyqësor ndaj pretendimeve



për trajtim jo të barabartë apo diskriminues. Kërkesë padia drejtuar gjykatës duhet të ketë disa veçori të cilat janë:

1-Identifikimi i grupimit të cilit i përket viktimë.

2-Identifikimi i fakteve që tregojnë diskriminimin. Evidencimi i shkeljes së një të drejte themelore, konventore ose ligjore dhe shkakun e përdorur për diskriminim.

3-Përshkrimi i ngjarjes, pa shprehur mendimin personal ose pozicionin.

4-Identifikimi i rasteve të ngjashme.

5-Konstatimi i trajtimit diskriminues si konkluzion.

Kërkesa mund të paraqitet në gjykatë nga çdo person që pretendon që është diskriminuar, çdo grup personash të cilët pretendojnë që janë diskriminuar apo një organizatë me interesa legjitime apo komisioneri në emër të një personi apo grupi personash. Është me rëndësi të theksojmë që ligji legjitimon për t'u ankuar ndaj sjelljeve diskriminuese edhe organizatat të cilat kanë interea legjitime, të tilla si TLAS të cilat punojnë dhe në thelb të veprimtarisë së tyre kanë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe rivendosjen në vënd të të drejtave të shkelura nëpërmjet asistencës që ato ofrojnë. Në procesin gjyqësor paditësi paraqet prova të cilat mbështesin padinë dhe të cilat provojë sjelljen diskriminuese, pala që ka barrën e provës ka të drejtë të justifikojë kryerjen e dallimit. Dhe në këtë rast, ndyshe nga gjykimet e zakonshme civile, barra e provës ka tendencën t'i



kalojë të paditurit apo personit i cili pretendohet të ketë kryer sjelljen diskriminuese, pasi është ky i cili duhet të provojë që sjellja e tij nuk ka qënë diskriminuese, e pabarabarte, e anshme apo të ketë cënuar barazinë e një apo disa personave.

Në fund të gjykimit, gjykata vendos pranimin ose rrëzimin e kërkesëpadisë duke u shprehur në lidhje me diskriminimin. Në rast se ajo e pranon kërkesëpadinë cakton edhe dëmshpërblimin, në rast se ajo konstaton se ka shkelje të ligjit specifik.

Dëmshpërblimi përfshin:

- 1-Ndreqjen e shkeljeve ligjore.
- 2-Pasojat e tyre përmes kthimit në gjëndjen e mëparshme.
- 3-Kompensimin e duhur për dëmet pasurore dhe jo pasurore.
- 4-Masa të tjera të përshtatshme.

Të drejtat themelore të njeriut janë të pacënueshme. Ato duhet të gëzojnë një mbrojtje të gjerë, ligjore dhe institucionale duke krijuar kështu siguri në zbat-

imin e tyre dhe në rivendojen në vend të të drejtave të shkelura. Në këtë mënyrë edhe e drejta për të qënë të ndryshëm dhe për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë duhet të ketë sigurinë e nevojshme ligjore dhe institucionale për çdo person. Ky rregullim i ri ligjor i hap rrugën një mbrojtjeje më efektive ndaj çdo shkeljeje në këtë drejtim. Çdo person duhet të njihet me të drejtat e tij, garancitë që i ofrohen dhe mjetet e ankimit, në mënyrë që të rivendoset në vend çdo e drejtë e shkelur.

**Anisa Metalla**  
**Avokate/këshilltare paraligjore,**  
**TLAS**



## Histori e Vërtetë 1

### Rasti i klientëve K.S dhe B.L

**K**lientët K.S dhe B.L u paraqitën pranë zyrave të Shërbimit Ligjor Falas, për të kërkuar ndihmë ligjore për zgjidhjen e problemit të tyre.

Klientët u intervistuan nga avokati i zyrës dhe u konstatua qe problemi i tyre ishte i tillë:

K.S dhe B.L janë prindërit e një fëmije të mitur. Nëna K.S e ka lindur fëmijën në maternitet, një vajzë, nga një marrëdhënie jashtëmartesore me shtetasin

B.L. Gjatë kohës së shtatëzarisë së nënës mes dy prindërve dhe familjeve të tyre lindën mosmarrëveshje të shumta. Nga këto paqëndrueshmëri në marrëdhëniet mes prindërve dhe familjeve të tyre situata u ndërlikua duke çuar në ndarjen faktike të dy klientëve K.S dhe B.L mes tyre.

Klientja pas lindjes, referuar situatës së ndërlikuar familjare dhe personale, tronditjes së thelle që pësuan ekulibrat e saj emocionalë dhe e detyruar edhe nga familjarët e saj, pas lindjes e braktisi fëmijën në maternitet. Pas këtij momenti fëmija u sistemua pranë një institucioni social të përkujdesjes.

Pas kalimit të një afati tre mujor mosinteresi për fëmijën sikurse parashikon dhe ligji, institucioni i përkujdesjes i'u drejtua gjykatës së rrethit gjyqësor duke kërkuar deklarimin e braktisjes së fëmijës. Gjykata pas shqyrtimit gjyqësor të fakteve dhe rrethanave të braktisjes së fëmijës e deklaroi atë të braktisur dhe vendosi sistemimin e fëmijës pranë institucionit të përkujdesjes.



Pas kalimit të një periudhe rreth gjashtë mujore nga kjo ngjarje, prindërit e fëmijës u shfaqën në institucionin e përkujdesjes ku ndodhej fëmija dhe u njohën me procedurat gjyqësore që ishin zhvilluar, gjithashtu u informuan që fëmija ndodhej tashmë në listat e Komitetit Shqiptar të Birësimeve gati për një procedurë birësimi.

Më pas ata ishin referuar nga institucioni i përkujdesjes për të kërkuar një zgjidhje ligjore në zyrën e Shërbimit Ligjor Falas, në sajë të bashkëpunimit tonë me këtë institucion.

Nga intervista që u zhvillua me ta dallohej qartë një ndjenjë pendimi dhe faji lidhur me ngjarjen që ato treguan. Dukej qartë pendimi dhe ndjenja e fajit të nënës për zgjedhjen që kish bërë për fëmijën e saj. Me atë sa e lejonte niveli i saj kulturor ajo mendohej të shpjegohej lidhur me rrethanat dhe gjëndjen në të cilën kishte vepruar. Pas kësaj bisede, nga avokati u konstatua që të dy prindërit e fëmijës i kishin sheshuar marëdhëniet me njëri-tjetrin dhe me familjet e



tyre. Tashmë ata jetonin bashkë dhe po kryenin edhe procedurat për lidhjen e martesës ligjore. Në përfundim ata kërkonin kthimin e fëmijës së tyre në gjirin e familjes, dhe zgjidhjen ligjore për këtë rast.

Situata në fakt paraqiste mjaft probleme për zgjidhje. Problemi i parë ishte që zgjidhja detyruesisht do të nënshtrohej zgjidhjes gjyqësore për të kërkuar kthimin e fëmijës.

Nga avokati i TLAS u shfrytëzuan të gjitha hapësirat e nevojshme ligjore për të pezulluar fillimisht procedurën e birësimit e cila tashmë kishte nisur.

Pas konsultimeve me avokatët e TLAS u vijua me përcaktimin



e detajeve teknike të kërkesë-padisë. Për t'u legjitimuar klientët si kërkues duhet të siguroheshim se si ishte hartuar akti i lindjes, nëse i kishte ky fëmijë amësinë dhe atësinë të njohura? Për këtë TLAS shfrytëzoi kontaktet e tij pasi pajisja me këtë dokument paraqiste vështirësi në përcaktimin e njësisë së gjëndjes civile ku ishte regjistruar fëmija dhe gjithashtu libri i akteve të lindjeve që përmbante edhe këtë akt, nuk arkivohej në të njëjtën mënyrë si të gjithë librat e tjerë pasi për këta fëmijë të braktisur kishte një libër më vehte. Pas disa përpjekjeve u arrit siguri i nje kopjeje të

këtij dokumenti, nga i cili u vërtetua se amësia ishte e njohur në aktin e lindjes (njohje të cilën e kishte realizuar punonjësja e institucionit të përkujdesjes ku ndodhej fëmija i sapolindur, pasi klientja K.S nuk kujtonte të kishte bërë asnjë veprim lidhur me dokumentat e fëmijës), por nga ky dokument vërtetohej se fëmija nuk e kishte të njohur atësinë. U kontaktua me klientët dhe u kërkua nga avokatët e TLAS që të bëhej njohja e atësisë. Kjo ishte e nevojshme në mënyrë që të dy prindërit të legjitimoheshin si kërkues në gjykatë pasi kjo do të ishte me bindëse për gjykatën. Duke u legjitimuar si kërkues të dy prindërit mund ti kishin më të bazuara kërkimet e tyre në funksion të përmbushjes së parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe të sigurisë që të dy ata ofronin për përmbushjen e disa kushteve të cilat duhet të ishin sa më bindëse për gjykatën. Pas kalimit edhe të këtij hapi, pra njohjes së atësisë së fëmijës, u procedua me pajisjen e të dy prindërve me kartat e identitetit me të cilat klientët



nuk ishin të pajisur, por këto dokumenta janë të domosdoshme për të patur akses në gjykatë dhe çdo institucion tjetër.

Hapi i fundit i punës së avokatit para fillimit të procedurës ishte hartimi i kërkesë padisë me elementet e saj të nevojshëm dhe depozitimi i kësaj padie në gjykatë për të filluar procedura gjyqësore. Procedura gjyqësore nuk ka përfunduar akoma, por çështja është drejt zgjidhjes në favor të klientëve K.S dhe B.L. Përfundimi duket të jetë i kënaqshëm në funksion të parimeve mjaft të rëndësishme të të drejtës familjare si ai i respektimit të të drejtës së gjithësecilit për jetë familjarë apo të interesit më të lartë të fëmijës i cili në këtë rast ishte riadhesimi i fëmijës pranë familjes biologjike, kushte të reja të cilat do ti sigurojnë atij ekulibrat e nevojshëm për mirëritje dhe edukim pranë familjes biologjike si të gjithë fëmijët e tjerë.

**Anisa Metalla**  
**Avokate/këshilltare paraligjore,**  
**TLAS**

## **Histori e Vërtetë 1**

### **Rasti i klientes L.P**

**K**lientja L.P nëpërmjet nënës dhe gjyshes së saj u drejtua në zyrat e TLAS për të marrë zgjidhje për problemin e saj.

Klientja L.P, e moshës 5 vjeçe, për shkak të një temperature shumë të lartë, është shtruar në repartin e urgjencës në Qendrën Spitalore Universitare “ Nënë Tereza” Tiranë, ku shoqërohej nga gjysha e saj.

Mjeku i urgjencës pasi ka vizituar pacienten, duke parë gjëndjen





e saj të rëndë shëndetësore, ka vendosur trajtimin e saj me anti-piretik paranteral (Paracetamol intramuskular, injeksion) si dhe perfusion (serum) për përmirësimin e gjëndjes së saj klinike. Me zbatimin e këtyre rekomandimeve u mor infermjerja e turnit. Në momentin e bërjes së injeksionit nga infermjerja, klientja L.P, ka reaguuar menjëherë, duke qarë deri në nxirje, ndërsa këmba e majtë i ka ngelur e ngrirë. Pas kësaj infermjerja ka thirrur menjëherë mjekun që kishte bërë rekomandimin. Ky i fundit ka vizituar klienten L.P dhe ka konstatuar se këmba ku ishte bërë injeksioni kishte humbur ndjeshmërinë. Në ditët në

vazhdim fëmija L.P ka qëndruar në spital, me qëllim rikuperimi të këtij deficieti neurologjik i cili sillte si pasojë probleme në ecje. Pas shtrimit 10 ditor kjo paciente ka dalë nga spitali me rekomandimin për në KEMP.

Klientja A.S nëna e fëmijës u paraqit në zyrën tonë pas fillimit të procedimit penal duke kërkuar ndihmë në këtë proces. Ajo u këshillua nga avokatët e TLAS që pasi të mbaronte procesin penal të drejtohej sërish pranë Shërbimit Ligjor Falas.

Në përfundim të procesit penal infermjerja e turnit është shpallur fajtores për veprën penale të "Mjekimit të pakujdesshëm", dhe është dënuar me gjobë, ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Pas këtij momenti klientja u këshillua që të kërkonte shpërbimin e dëmit jashtëkontraktor nga institucioni spitalor. Për këtë rast u diskutua nga stafi i TLAS dhe u vendos që të ndiqej nga avokatët e zyrës. Avokati u kujdes për hartimin e kërkesë padisë dhe mbledhjen e provave.

Në kërkimet parashtuar gjykatës u argumentua se paditësja ka pësuar një dëm në shëndet. Gjithashtu nga vendimet penale të arsyetuara për këtë rast është e vërtetuar lidhja shkakësore mes veprimit dhe pasojës së ardhur në shëndetin e paditëses nga infermierja e institucionit spitalor, pra pasoja e ardhur, dëmtimi i shëndetit të paditëses në këtë rast, paraliza e menjëhershme e këmbës, ka ardhur si pasojë e veprimit mekanik, injeksionit të bërë jo në mënyrën e duhur nga infermierja.

U kërkua shpërblimi i Dëmit jopasuror i cili përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cënimi i të drejtave dhe interesave jopasurore që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlerësimi të drejtëpërdrejtë ekonomik në treg.

Dëmtimi i shëndetit është objekt kërkimi dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësura nga i dëmtuari për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm. Në rastin e klientes L.P, dëmtimi i shëndetit apo dëmi biologjik që

ka ardhur si pasojë e faktit të paligjshëm, është pasoja e parë direkte që ka ardhur dhe nga e cila lind e drejta e dëmshpërblimit.

Në kuptim të dëmit moral si shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Cildo që pëson cënime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti ka të drejtën të kërkojë



edhe dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar. Klientja L.P ka pësuar një tronditje te thellë si pasojë e dëmit dhe paaftësisë që ai i ka shkaktuar. Shpesh herë ajo shfaqet e vetmuar në përditshmërinë e saj pasi ndjen dhe vuan dallimin fizik që ka pësuar me moshatarët e saj duke i penguar kështu të shfaqet e lirshme, e shpenguar dhe e çlirët në raport me të tjerët.

Dëmi ekzistencial i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit cënon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thuajse në mënyrë të përher-

shme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtaritë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjendjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizojnë pozitivisht qënien e tij apo mund t'a karakterizojnë pozitivisht në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dorë nga këto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm. Dëmi ekzistencial, duke mos patur natyrë thjesht ndjesore e të brendshme, është objektivisht i vërtetueshëm edhe në rastin e klientes L.P, duke qënë e mitur dhe në formim të vazhdueshëm të personalitetit të saj, gjendja e paaftësisë së saj fizike l shkakton vuajtje dhe mundim





në procesin e saj të rritjes duke ndikuar në vlerësimin dhe konsiderimin e vetvetes. Ky dëmtim i pësuar pengon në mënyrë të vazhdueshme shfaqjen e saj të jashtme si njeri. Veprimtaria e saj e përditshme është tronditur, duke e penguar të shfaqet dhe të ushtrojë e lirshme veprimtaritë normale të moshës së saj, si të luajë, të ecë të vrapojë.

Rasti i Klientes L.P është në gjykim dhe akoma nuk ka përfunduar. Në fazën në të cilën ndodhet gjykimi ai është në favor të klientes për t'u shpërblyer nga ana e institucionit spitalor për dëmet të cilat ajo ka pësuar në shëndetin dhe qënien e saj.

**Anisa Metalla**  
**Avokate/këshilltare paraligjore,**  
**TLAS**







SHERBIMI LIGJOR FALAS TIRANE

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)  
Rruga "Sami Frashëri"  
4 kullat, Seksioni 3, Ap. 1A, Tirana, Albania  
Tel/Fax: +355 4 2258 442  
Tel: +355 4 2253 114  
Kutia Postare 69  
E-mail: [tlas@tlas.org.al](mailto:tlas@tlas.org.al)  
[www.tlas.org.al](http://www.tlas.org.al)

TIRANA LEGAL AID

Design: [ederstudio.com](http://ederstudio.com)  
Cel: 069 20 92 922

# SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Nr. 1 / 2011

## TLAS

